



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 5 Datë 24.01.2018

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS

“ PËR PËRDORIM TË BURIMEVE UJORE ”

Në mbështetje të ligjit nr.111/2012 dt.15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të nenit 38 “Qëllimet e përdorimit të burimeve ujore” gërma b, dhe të nenit 41 “Përdorimi me leje i ujit” gërma a dhe ë; të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 , “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje për përdorim të burimeve ujore”, bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin-Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I :

1- Të miratojë kërkesën për rinovim të lejes e **Z. Pashuk DRINI**, me vendndodhje në fshatin Ganjolle , Njësia Administrative Guri i Zi, Bashkia Shkodër, Qarku Shkodër për përdorim të burimit ujor (kanal vaditës Spathar-Juban-Guri i Zi), për Akuakulturë.

Vepra e marrjes ka këto koordinata: X - 46 53 660; Y - 43 83 750; Z - +18 m;

Pika e shkarkimit ka këto kordinata: X - 46 53 660; Y - 43 83 730; Z - +18 m;

Prurja mesatare vjetore e burimit është 0.06 m³/sek.

Prurja mesatare e muajit më të thatë është 0.05 m³/sek.

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti është 0.044 m³/sek , (44 l/sek).

2-Leja e përdorimit të burimit ujor jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Cesk MILLJA

